



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0560

OSHP: 2023/0572

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare dhe Isa Hasani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Grupi i Operatoreve Ekonomik (GOE) “Asfalt Group SH.P.K.-Gurebardhi SH.P.K.- Benita Company - Dreoni SH.P.K.- Gremnik, Kline, 3200, Kosove.” & ”Viktory Com, Pjeter Qerimi B.I - Company Eskavatori SH.P.K.- Marish SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndertimi I Rruges X”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Komuna e Gjakoves, me datën 08.12.2023, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e Grupit te Operatoreve Ekonomik “Asfalt Group SH.P.K.-Gurebardhi SH.P.K.- Benita Company - Dreoni SH.P.K.- Gremnik, Kline, 3200, Kosove.”, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 11.08.2023 me numër protokolli 2023/0560, për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndertimi I Rruges X” me nr. të prokurimit: 632-23-397-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Gjakoves.

2. Aprovohet, si e bazuar ankesa e Grupit te Operatoreve Ekonomik ”Viktory Com, Pjeter Qerimi B.I - Company Eskavatori SH.P.K.- Marish SH.P.K, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 11.08.2023 me numër protokolli 2023/0572, vendimi për dhënie lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndertimi I Rruges X” me nr. të prokurimit: 632-23-397-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Gjakoves, anulohet, lënda kthehet në rivlerësim.

3. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 14.04.2023, Komuna e Gjakoves , në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndertimi I Rrugës X” me nr. të prokurimit: “632-23-397-5-1-1” Nderkaq me datën 24.07.2023 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK.

GOE “Asfalt Group SH.P.K.-Gurebardhi SH.P.K.- Benita Company - Dreoni SH.P.K.- Gremnik, Kline, 3200, Kosove.” & ”Viktory Com, Pjeter Qerimi B.I - Company Eskavatori SH.P.K.- Marish SH.P.K. me datën 28.07.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. AK- Komuna e Gjakoves me vendim ka refuzuar si te pa bazuar kërkesën për rishqyrtim të GOE: “Asfalt Group SH.P.K.-Gurebardhi SH.P.K.- Benita Company - Dreoni SH.P.K.- Gremnik, Kline, 3200, Kosove.” & ”Viktory Com, Pjeter Qerimi B.I - Company Eskavatori SH.P.K.- Marish SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndertimi I Rrugës X” me numër të prokurimit: 632-23-397-5-1-1 inicuar nga – Komuna e Gjakoves.

Te pakënaqur me vendimin e AK-së, GOE ankues: “Asfalt Group SH.P.K.-Gurebardhi SH.P.K.- Benita Company - Dreoni SH.P.K.- Gremnik, Kline, 3200, Kosove.” & ”Viktory Com, Pjeter Qerimi B.I - Company Eskavatori SH.P.K.- Marish SH.P.K me datën 11.08.2023 kane parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 560/23-572/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: Punë, vlera e parashikuar e kontratës: 4,357,000.00 €.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Paneli Shqyrtues konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se ka nevojë të mbahet seanca publike me palë dhe për këto lëndë me qëllim të sqarimit sa më në detaje paneli shqyrtues mbajti dy seanca në prani të palëve u prezantuan të gjitha provat të mjaftueshme për të vendosur lidhur me këtë lëndë njëra është mbajtur më dt. 10.11.2023, e tjetra më dt. 29.11.2023 . Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Pohimet ankimore të OE ankues "Asfalt Group SH.P.K.-Gurebardhi SH.P.K.- Benita Company - Dreoni SH.P.K"

Ankuesi, ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të AK nga aspekti i eliminuar të tij/sajë se (sipas AK) Lideri Asfalt Group shpk, ka prezantuar listen e kontratave të perfunduara ku vlera totale e tyre është 1,808,522.58 €, në kërkesën mbi mundësitë teknike dhe ose profesionale pika 9.1 & 9.2 është kërkuar: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka perfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Në një vlerë prej jo më pak se 6,535,000,00€; gjatë tre viteve të fundit, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% të vlerës së qarkullimit. Pra lideri, në këtë rast Asfalt Grup shpk, duhet të kishte kontrata të perfunduara në tri vitet e fundit në vlerë të minimumit: $(6,535,000.00 \text{ €} \times 60\%) = 3,921,000.00 \text{ €}$, pra kjo ofertë nuk e plotëson këtë kusht që është fakt eliminues nga ky tender. Duke pasur parasysh se Grupi i OE nuk i plotësoni kërkesat e sipërpermendur të FDT-së, perkatesisht ka prezantuar liste për kontrata të realizuara dhe lista të pajisjeve të cilat nuk janë në përputhje me listen për kontrata të realizuara dhe listen e pajisjeve sipas aneks 7 të FDT-së, andaj kjo ofertë është refuzuar për shkak se dy listat e lartë cekura nuk janë plotësuar dhe dorezuar ashtu siç kanë qenë të përcaktuara në FDT (ka qenë obligim plotësimi dhe dorezimi i tyre me ofertë). Për mungesë të dokumenteve tek stafi profesional që janë cekur me lartë, nuk është kërkuar sqarime shtesë konform nenit 72 të LPP-së për shkak se mungojnë listat e lartë cekura të cilat janë fakt eliminues për ofertën tuaj. Fillimisht ju sqarojmë se është e paqëndrueshme arsyeja e eliminimit, sepse në e plotësojmë kërkesën në lidhje me kontrata të natyrës së ngjashme në vlerën e kërkuar 6,535,000.00 €, e po ashtu edhe lideri e plotëson kërkesën prej 60 % të vlerës së kërkuar. Në dosje të tenderit kemi bashkangjitur listen e kontratave të Liderit me 18 kontrata dhe dëshmi të perfundimit të tyre, e ku vlera e kontratave arrijnë 1,808,522.58 €, ashtu siç e ka cekur edhe autoriteti kontraktues për këtë liste. Në, përveç listës së lartëpermendur të punëve me autoritet publikë, ju informojmë se në dosje të tenderit kemi bashkangjitur edhe dëshmitë e kryerjes së punëve me kompani private, por që për shkak të një lëshimi teknik nuk kemi bashkangjitur listen e kontratave me kompani private. Kur analizohen dëshmitë e perfundimit të punëve me kompani private rezulton se lideri ASFALT GROUP SH.P.K., e tejkalon vlerën e kontratave të kërkuara në dosje të tenderit, pra përmbushet kërkesa nga ana jone që lideri të ketë 60 % të vlerës së kontratave. Lidhur me këtë ekspert shqyrtues këtë pretendim e ka klasifikuar si të bazuar duke konkluduar se OE ankues përveç listës së paraqitur të punëve me autoritet publikë, OE ankues në dosje të tenderit ka bashkangjitur edhe dëshmitë e kryerjes së punëve me kompani private, por që nuk ka bashkangjitur në listen e kontratave me kompani private. Bazuar në ligjin LPP Nr. 04-L- 042 & 05-L-068 & 05-L-092 Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë 3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistencë e të cilave është e

fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive Nga ky shpjegim AK eshta dashur te kerkje informacione shtese nga OE ankues per te verifikuar se keto informacione jane te vlefshme apo jo bazuar ne nenin 72 si me siper. Për të verifikuar dokumentet dhe informacionin e ofruar nga operatori ekonomik (OE) ankues, autoriteti kontraktues zakonisht i konsideron të gjitha elementët e paraqitur në dosjen e tenderit duke i verifikuar. Nëse ju keni marrë dokumentacion plotësues nga OE i rekomanduar për kontratë dhe OE ankues jo, është e rëndësishme të siguroheni që të gjithë informacioni të jetë i barazvlefshëm dhe i përshtatshëm për kërkesat e tenderit për të gjithë OE. Në disa raste, autoriteti kontraktues mund të ndërmarrë hapa shtesë për të verifikuar informacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë, përfshirë edhe OE-të ankues. Është bere kalkulimi i vleres se kontratave te perfunduara ne 3 vitet e fundit duke filluar nga data e njoftimit per kontrate me kompani private e cila nuk ka qene e dorezuar ne oferte por ne baze te Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë kam bere kalkulimet. Iera e kontratave te realizuara TOTAL eshte 5,918,053.72 te cilen e tejkalon vleren e 60%. Kjo është një tregues që lideri i kompanisë "ASFALT GROUP SH.P.K." ka tejkaluar vlerën e kontratave të kërkuara në dosjen e tenderit, duke plotësuar kërkesën që lideri të ketë 60% të vlerës së kontratave. Është e rëndësishme të plotësohen të gjitha kriteret dhe kërkesat e dokumentacionit të tenderit. Në këtë rast, vlera e kontratave të mbuluara është një faktor kryesor që autoriteti kontraktues eshte dashur ta vlerësojë për të përcaktuar aftësinë për të përmbushur detyrimet e tenderit. Pretendimi juaj ankimor është i bazuar në informacionin e vërtetuar dhe të dokumentuar që keni për deshmimit e perfundimit të punëve të kompanisë "ASFALT GROUP SH.P.K."

Lidhur me këtë konstatim të ekspertit paneli shqyrtues nuk pajtohet për faktin se as ankuesi dhe as eksperti nuk ka paraqitur asnjë provë konkrete dhe/ose bindese per panelin duke mos paraqitur saktë gjendjen reale të këtij pretendimi ankimor karshi kërkesës së Dosjes së Tenderit, ngase OE pjesëmarrës kanë qenë të obliguar së këtë kërkesë ta plotësojnë ashtu siç është e paraqitur, për shkak se me rastin e ofertimit i kanë pranuar të gjitha kushtet e dosjes së tenderit pa ndonjë kufizim. Kjo është e përcaktuar në Formularin e Tenderit të dorëzuar nga vet ata, po edhe në nenin 17.7 të RRPP, i cili citon: *Pjesa C, Formulari për dorëzimin e ofertës, është pjesa kryesore e tenderit, sepse në këtë pjesë ofertuesi deklaron se ai ka kontrolluar dhe pranon të gjitha kushtet e tenderit dhe dorëzon ofertën e tij financiare*". Kështu që kërkesa e Dosjes së Tenderit ka qenë "Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve, në rast se Operatori Ekonomik prezanton kontrata dhe referenca me Operator Ekonomik privat atëherë Operatori Ekonomik duhet të prezanton situacionet e nënshkruara së bashku me transaksionin bankar, që përputhen me të njëjtën kontratë-referencë". Nisur nga ky fakt nga bindja e pavarur e Panelit Shqyrtues ,OE nuk ka arritur të dëshmoj para panelit shqyrtues se i njëjti për transaksionet e ofruara në ofertë ka pasur kontrata të realizuara dhe që këto transaksione të jenë me situacione të nënshkruara ashtu siç ka qenë kërkesa e Dosjes së Tenderit. Për paraqitjen e këtyre dëshmive OE ankues i ka pasur shumë herë mundësi që ta argumentoj përgjegjshmërinë e tij, duke prezentuar kontratat, pranimet e situacioneve të pranuar të bashkangjitura me transaksionet bankare. Ankuesi ashtu sikurse në kërkesë për ri-shqyrtim edhe në ankesën e tij ka ofruar dokument shtesë vetëm listën e cila titullohet si listë e kontratave të realizuara me kompani private, ku shumica prej tyre emertohen "asfaltme" por ka deshtuar te bashkangjese "kontrata dhe situacione të nënshkruara" për transaksionet të cilat i ka të bashkangjitura në ofertë kurse nga ana tjetër referencat të cilat i ka në ofertë pothuajse në

asnjërën prej tyre nuk citohen se ka përfunduar kontratat me sukses por vetëm se kanë bërë furnizimet me asfalt. Andaj përfundimisht panelin vlerëson se komisioni i vlerësimit profesional pranë AK me të drejtë kishte konstatuar se lideri i grupit nuk kishte arritur të dëshmojë se ka plotësuar kërkesën e DT prej 60% të vlerës së kontratave të realizuara, andaj si rezultat i këtyre OE ankues Asfalt Group SH.P.K.-Gurebardhi SH.P.K.- Benita Company - Dreoni SH.P.K nuk janë të përgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit. Po ashtu vlen të potencohet se kjo çështje kontestimore është e rregulluar edhe me legjislacionin sekondar Udhëzuesi për prokurim publik në të cilën shprehimisht parashihet se në rast se Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës së përcaktuar atëherë refuzo tenderin pa kërkuar informacione shtesë, kësaj pike ju ka përmbajtur edhe komisioni profesional i prokurimit pranë AK. Megjithatë, paneli shqyrtues për hirë të primeve të përgjigjshme të LPP e ka vlerësuar ofertën e ankuesit përfshirë të gjitha dëshmitë e ofruara për plotësimin e kësaj kërkesë dhe erdhi në përfundim se i njëjti nuk ka arritur të plotësojë kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore të OE ankues ndaj OE të rekomanduar për kontratë, Paneli Shqyrtues nuk do të ndalet tek secili pretendim ankimor, por të ndalet vetëm tek pretendimet ankimore që janë përcaktuese në vendimarrje meritore sa i përket çështjes së OE të rekomanduar për kontratë, si në vijim:

Ankuesi, ka atakuar vendimin e AK nga aspekti i përgjegjshmërisë së OE të rekomanduar për kontratë duke pretenduar se Tek lista e pajisjeve në dosje të tenderit tek numri render 3 është kërkuar Kamion (dumper) min 30 (kamionet duhet të kenë çertifikate të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit). Në lidhje me këtë kërkesë grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka ofruar koka terheqese si në vijim: 1. Koka terheqese AB136CS Kazan AHR241 2. Koka terheqese AAR879 Kazan AA763DR 3. Koka terheqese AB974CM Kazan AHR247 4. Koka terheqese AB349JA Kazan ACR886 Dëshmitë e ofruara në lidhje me këtë kërkesë nuk janë sipas kërkesës, sepse janë ofruar Kamiona shlepera të cilat nuk janë dumpera dhe kjo vërtetohet shumë lehtë kur krahasojmë fotot e Dumperave të cilat i kemi ofruar ne, me kokat terheqese dhe librezat të cilat i ka ofruar grupi i OE të rekomanduar për kontratë, e ku shihet që përveç tjerash pesha nuk është 30 ton. Për Dumper, AK-ja ka kërkuar sqarime shtesë duke e pyetur grupin e OE të rekomanduar për kontratë se kokat terheqese dhe gjysëmrimorkiot e ofruara nga grupi, a e kryejnë funksionin e njëjti si të kamionit dumper? Me këtë kërkesë për sqarime shtesë, vetë AK-ja faktikisht e ka pranuar që grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi sipas kërkesës, prandaj në këtë rast është dashur të eliminojë këtë grup dhe ofertën e tyre të shpall të papërgjegjshme. Po ashtu edhe vetë OE i rekomanduar për kontratë në sqarimet e lartëkura e ka konfirmuar se nuk ka ofertuar sipas kërkesave të dosjes së tenderit, ku për Dumper përgjigjen dhe sqarimin e ka dhënë si në vijim: Makinerite dumper të paraqitura nga ana jone, i plotësojnë të gjitha kriteret sipas kërkesës, e që kanë peshën e njëjti, kazanin e kanë të njëjti si të dampereve si dhe gomat janë të mëdha si të dampereve, të cilat mundën të shihen edhe nga fotot e paraqitura. Nga këto sqarime kuptohet qartë se grupi i OE të rekomanduar për kontratë e ka pranuar vetë se nuk ka ofruar dëshmi për Dumper por është mundur të barazojë në aspektin funksional kokat terheqese dhe gjysëmrimorkiot e ofruara nga ky grup. Për më tepër shihen qartë kundertheniet e grupit të OE të rekomanduar për kontratë sepse në njërën anë flasin për makinerite dumper e në anën tjetër e theksojnë se karakteristikat e këtyre makinerive kanë të njëjta me Dumperat. Nga ky sqarim kuptohet qartë papërgjegjshmeria e grupit të OE të rekomanduar për kontratë. Sqarimi i kërkuar në këtë rast është i kunderligjshëm dhe përben favorizim të hapur për grupin e OE të rekomanduar për kontratë. Veprimi për të kërkuar sqarime nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë përben favorizim të hapur, sepse mund të ketë kompani që nuk ka poseduar Dumper e që ka poseduar gjysëmrimorkio dhe koka terheqese dhe

qe nuk ka ofertu ne kete tender shkaku i kerkesave dhe makinerive specifike, prandaj trajtimi ne kete rast duhet te behet konform kerkesave to FDT-se dhe te njoftimit per kontrate e jo te lejohen ndryshime substanciale. Me keto deshmi ka qene e qarte se ky grup i OE te rekomanduar per kontrate nuk ka ofruar deshmi sipas kerkesave te dosjes se tenderit, prandaj automatikisht eshte dashur te eliminohet nga konkurrenca e jo te kerkohen sqarime. Kerkojme nga ekspertet e OSHP-se qe te analizohen ne detaje deshmitet dhe librezat e ofruara nga grupi i OE te rekomanduar per kontrate dhe te krahasohen me kerkesat e dosjes se tenderit dhe specifikat e makinerive te kerkuara. Per te qene nje OE i pergjegjshem duhet qe tenderi ne fjale te jete ne perputhshmeri me te gjitha kerkesat e parashtruara ne njoftimin e kontrates dhe ne dosjen e tenderit dhe kete e parasheh neni 59 paragrafi 4 i LPP-se. Ne kete rast tenderi i grupit to OE "PE -LA-KU SH.P.K. DEGA Ne KOSOVE; JOOS & KRASNIQI BAZE SH.P.K.; Roza Romani B.1., Rr. Tringe Smajli 1617, 10000, Prishtine nuk eshte ne perputhje me kerkesat e dosjes se tenderit. Eksperti shqyrtues teknik ka konstatuar se jane verifikuar nga oferta GOE fitues makinat Dumper kamion e GOE fitues per te cilen thuhet se eshte huazuar nga kompania "G.P.G Company"sh.p.k, por shihet nga kjo kompani se NUK jane huazuar makinat Dumper kamion, andaj vleresojë **të bazuar** pretendimin ankimor të OE ASFALT GROUP SH.P.K. Paneli shqyrtues ia fal besimin ekspertit shqyrtues dhe pretendimin e klasifikon si të bazuar.

Ankuesi, ka atakuar vendimin e AK nga aspekti i pergjegjshmërisë së OE të rekomanduar për kontratë duke pretenduar se Tek lista e pajisjeve ne dosje te tenderit tek numri rendor 8 eshte kerkuar: Ngarkues min 32t -I cope, ndersa OE i rekomanduar per kontrate ka ofruar nje marreveshje me BIBA X shpk per Ngarkues Liebherr L564 (ne dud doganor 32.700.0000). Grupi i OE te rekomanduar per kontrate ka bashkangjit edhe deshmi per nje Liebherr L574 me peshe 25.500 ton, e i cili normalisht eshte me i madh me peshe se sa Liebherr L564. Ketu shihet kunderthenia e deshmise se ngarkuesit Liebherr L564 me peshe 32,700.0000 me gjendjen reale. Prandaj kerkojme nga ekspertet e OSHP-se qe te analizohen sakte dhe te krahasohen deshmitet dhe faktet se cili ngarkues ka peshe me te madhe dhe qarte do te verehet kunderthenia e deshmitet te ofruara te grupit te OE te rekomanduar per kontrate. Kur analizohen dhe verifikohen ne internet/kataloge verehet se Liebherr L564 ka me peshe 22-25 ton por nuk ka 32 tone. Poashtu eshte e cuditshme pesha e shenuar 32.700.0000, pra me kater zero pas pikes. Sa i perket sqarimeve te ofruara per Ngarkues min 32t -I cope, grupi i OE te rekomanduar per kontrate ka dhene sqarimin si ne vijim: Pika 8, ngarkusja mbi 32 ton eshte e marrur me qera nga kompania "Biba X" ne Shqiperi. kontrate eshte ne pjesen e 29 to dosjes se tenderit, tek fagja 200 eshte kontrata e qeras per kete makineri, ndersa dudi ose dokumenti per kete makineri eshte ne faqen 311. Duke pasur parasysh sqarimet e lartepermendura kerkojme nga ekspertet e OSHP-se qe te verifikohen te dhenat e kesaj pajisje ne internet, e ku mund te vertetohet pretendimi jone ankimor. Konstatojë se, oferta e GOE fitues për makinën Ngarkues 32 [t] nuk është në përputhje me kërkesat teknike të dosjes së tenderit, dhe se pretendimin ankimor të OE ASFALTI GROUP SH.P.K se GOE fitues ka ofruar dëshmi DUD-in dhe kontratën e qirasë për markën LIEBHERR L 564 dhe se si foto dëshmi ka ofruar markën LIEBHERR L 574 vleresojë **si të bazuar**. Paneli shqyrtues ia fal besimin ekspertit shqyrtues dhe pretendimin e klasifikon si të bazuar.

Ankuesi, ka atakuar vendimin e AK nga aspekti i pergjegjshmërisë së OE të rekomanduar për kontratë duke pretenduar se Tek lista e pajisjeve ne dosje to tenderit tek numri rendor 12 eshte kerkuar: Luge hidraulike Ripper min. 2.5t maksimum 3t, ndersa grupi i OE te rekomanduar per kontrate ka ofruar si deshmi: -Ngarkues me lopat marka HONOMAG -Ngarkues me lopat marka Liebherr Keto dy makineri qe i ka prezantuar grupi i OE te rekomanduar per kontrate NUK jane lug hidraulike Ripper 2.5-3 ton. Perveq se nuk jane luge hidraulike, te njejtat pajisje te prezantuar nga ky grup jane edhe me pesha me te medha se sa kerkesa sic eshte kerkuar 2.5-3 tone. Keto

pajisje mund të jene të nderlidhura me piken 8 të listës së kerkuar të pajisjeve ku është kerkuar Ngarkues min 32t , mirepo edhe me këto kërkesë nuk perputhen deshmite e peshës së kerkuar prej 32 tone, sepse njera pajisje ka peshë 9 tone, ndërsa tjetra 24.420 tone sipas DUD doganor. Edhe për këto pajisje janë kerkuar sqarime shtese, ndërsa me sqarime grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka dhënë sqarimet si në vijim: Për piken e 12 janë prezentuar dy luga ngarkuese me lopat, ndërsa është kerkuar Ripper me peshë min 2. 5t dhe maksimum 3t. Ngarkuset me lopat të cilat i kemi paragitur, lopaten e kanë të llojit Ripper mirepo, meqenese nuk kanë dud ose dokument ndaras nga ngarkuset, atehere është dashur që të futen së bashku me makinerin ngarkuese, por që lloji i lopatës është e njëjta me atë që është kerkuar. Edhe nga sqarimi i dhënë nga vete grupi i OE të rekomanduar për kontratë kuptohet qartë se deshmite e ofruar nga ky grup nuk kanë janë luge hidraulike Ripper. Për më tepër grupi i OE të rekomanduar për kontratë me sqarime, e ka çekur ngarkuesit me lopatë, por ju sqarojme se Luga hidraulike Ripper nuk është për ngarkim por është luge hidraulike për nxjerrjen e gureve apo materialeve të forta. Pra edhe nga sqarimi i vete grupit të OE të rekomanduar për kontratë kuptohet qartë se deshmite e ofruara nga grupi OE të rekomanduar për kontratë nuk janë në harmoni kërkesat e dosjes së tenderit. Është shumë e qartë se edhe në aspektin funksional nxjerrja e gureve dhe materialeve të forta DALLON me ngarkimin e këtyre materialeve. Eksperti shqyrtues ka konstatuar se GOE fitues ka ofruar dëshmi vetëm DUD-in ku pretendon se është me makinën Ngarkuesit me Lopatë dhe nuk ka ofruar dëshmi shtesë Bazuar në kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, këtë deklaratë e ka bërë në senacën e mbajtur me palë duke konstatuar se pretendimi ankimor është i bazuar. Paneli shqyrtues ia fal besimin ekspertit shqyrtues dhe pretendimin e klasifikon si të bazuar.

Ankuesi, ka atakuar vendimin e AK nga aspekti i përgjegjshmërisë së OE të rekomanduar për kontratë duke pretenduar se Tek lista e pajisjeve në dosje të tenderit tek numri rendor 14 është kerkuar: Kamion për transport betoni (auto betonierke-mixer) (kamioni duhet të ketë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit), ndërsa grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka ofruar dëshmi si në vijim: Kamion me targa AA 247 ZV Kamion me targa AB 453 CJ Kamion me targa AB 928 CO Kamion me targa AA 921 CO. Këta kamiona janë në pronesi të kompanisë ALESIO 2014 SHPK, mirepo për këta kamiona nuk ka asnjë marrëveshje ndërmjet PEVLAKU SHPK me Alesio 2014 SHPK se i ka marrë me qira këto pajisje. Prandaj këto dëshmi nuk kanë asnjë vlerë në këto projekt dhe ligjerisht nuk mund të merren parasysh. Me sqarime shtese grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka ofruar edhe një kontratë qiraje të lidhur ndërmjet ALESIO 2014 SHPK si qiradhenes dhe PEVLAKU SHPK si qiramarres por kontrata ka të bëjë për projektin "Ndertimi i rrugës dalja për peje-pjesë e qarkorës së qytetit"-KK Gjakovë. Thjesht kjo kontratë për qira është e pavlefshme dhe nuk mund të merret parasysh sepse është e lidhur për një projekt tjetër. Kjo kontratë nuk ka vlerë për asnjë nga pajisjet që janë të çekuar në këto kontratë sepse nuk ka të bëjë me këto projekt dhe nuk konsiderohet e vlefshme. Kontrata për pajisjet e lartëkura vlen vetëm për një projekt dhe atë është i çekur projekti për të cilin janë marrë vesh, pra për projektin Ndertimi i rrugës dalja për peje-pjesë e qarkorës së qytetit"-KK Gjakovë. Kjo kontratë është specifike dhe duhet të trajtohet njëjtë nga të gjitha paletat dhe nuk mund të perdoret kontrata specifike për projekte të përgjithshme pa qenë specifikuar. Eksperti shqyrtues deklaroi se Kamion për transport betoni (auto betonierke-mixer) (kamioni duhet të ketë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit), ndërsa grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka ofruar dëshmi si në vijim: Kamion me targa AA 247 ZV, Kamion me targa AB 453 CJ, Kamion me targa AB 928 CO, Kamion me targa AA 921 CO Këta kamiona janë në pronesi të kompanisë ALESIO 2014 SHPK, mirepo për këta kamiona nuk ka asnjë marrëveshje ndërmjet PEVLAKU SHPK me Alesio 2014 SHPK se i ka marrë me qira këto pajisje lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndertimi i Rrugës X" me nr. të

prokurimit: "632-23-397-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS. Nëse grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka ofruar një kontratë qiraje të lidhur ndermjet ALESIO 2014 SHPK si qiradhënës dhe PEVLAKU SHPK si qiramarrës për projektin "Ndërtimi i rrugës dalja për Pejë - pjesë e qarkores së qytetit" në Gjakovë, kjo është një kontratë që nuk i perket aktivitetit të prokurimit: "Ndërtimi i Rrugës X" me nr. të prokurimit: "632-23-397-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS dhe si e tillë është e pa vlefshme. Kur një kompani ka nevojë për pajisje me qera për të zhvilluar një projekt specifik, është e rëndësishme të ketë një kontratë të lidhur për qira të këtyre pajisjeve për projektin perkates. Në kete rast, pasi kontrata e qirajit është e lidhur për projektin e caktuar "Ndërtimi i rrugës dalja për Pejë - pjesë e qarkores së qytetit", ajo nuk ka validitet për të vlerësuar si kontratë e lidhur ndërmejt dy paleve për projektin në fjale. Në dosje të tenderit nuk është kjo kontratë por pas kërkeses për informate shtese nga AK drejtuar OE të rekomanduar për kontratë është dërguar kjo marrëveshje e cila nuk i plotëson kërkesat e një kontrate për aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i Rrugës X" me nr. të prokurimit: "632-23-397-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS. Pretendimi juaj ankimor është i bazuar në informacionin e vërtetuar dhe të dokumentuar, pra kontratë e prezentuar nga OE të rekomanduar për kontratë pas kërkeses për informacione shtese është dërguar kjo marrëveshje e cila nuk i plotëson kërkesat e një kontrate për aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i Rrugës X" me nr. të prokurimit: "632-23-397-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS. Paneli shqyrtues ashtu sikurse ekspertit shqyrtues konstaton se pretendimin e klasifikon si të bazuar.

Ankuesi, ka atakuar vendimin e AK nga aspekti i përgjegjshmërisë së OE të rekomanduar për kontratë duke pretenduar se Tek lista e pajisjeve në dosje të tenderit tek numri rendor 23 është kërkuar: Kamion sperkates për bitum dhe emulsion-1. Me sqarim shtese në lidhje me kete pajisje, grupi i OE të rekomanduar për kontratë është përgjigjur si në vijim: Për piken 23, Kamion sperkatese për bitum dhe emuluzion Edhe kjo makineri është makineri e mare me kontratë qeraje nga Shqiperija, nga kompania "Alesio -2014" shpk e cila gjendet në pjesën e 29 të dosjes së tenderit, tek faja 202, ndërsa dokumenti i mjetit në fjale është në faqen 268, ku është e paraqitura fatura e blerjes nr.18 me të dhënat dhe dokumentet tjera të mjetit, Nga analizimi i dokumentacionit të këtij grupi të OE të rekomanduar për kontratë dhe nga sqarimi i dhënë në lidhje me kete pajisje, ju sqarojmë si në vijim: Në pjesën nr.29 të dosjes së tenderit të dorëzuar nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë është një kontratë qiraje ndërmjet Qiradhenesit ALESIO 2014 SHPK dhe qiramarrësit PEVLAKU SHPK, ku pajisjet të cilat merren dhe jepen me qira në kete marrëveshje janë në listuar si në vijim: Duke qenë se; Nga kjo listë shihet qartë se NUK ka dhënie/marrje me qira për pajisjen Kamion sperkates për bitum dhe emulsion. Pra kjo pajisje nuk është pjesë e kontratës në fjale. Sa i përket përgjigjes me sqarime, ku është cekur fatura e blerjes me Nr.18 në faqen 268, ju sqarojmë se në kete faturë figuron se e në kete faturë figuron se e ka blerë ALESIO 2014 SHPK një kamion të përdorur me cisterne bitumi, mirepo kjo faturë nuk ka të bëjë fare me kontratën për qira të pajisjeve dhe kjo pajisje e cekur në faturë nuk është pjesë e kontratës, të cilit i është referuar edhe vetë grupi i OE të rekomanduar për kontratë. Thjesht kjo faturë është një dokument i përndësishëm dhe i pavlerë për kete projekt sepse nuk është i përfshirë në kontratë për qira për pajisje. Për më tepër fatura është goxha e padukshme dhe e paqarte. Me sqarime shtese grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka ofruar edhe një kontratë qiraje të lidhur ndërmjet ALESIO 2014 SHPK si qiradhenes dhe PEVLAKU SHPK si qiramarrës, e ku në listën e kësaj kontrate gjendet Kamion sperkates për bitum Targa AA 704 PY. Me kete ngjyre e ka hijezuar vetë grupi i OE të rekomanduar për kontratë duke aluduar se kjo pajisje është marrë me qira, mirepo ju sqarojmë se kjo pajisje është pjesë e kontratës së qirës së dt.18.05.2023, e që kjo kontratë nuk ka të bëjë me projektin që ka

ofertuar ky grup dhe per te cilin i ka dhene sqarimet, por kjo kontrate eshte per nje projekt tjetër, e ku ne kete kontrate shkruan qarte si ne vijim: Duke qene se: Shoqeria "PE-VLA-KU" sh.p.k. merr pjese ne tenderin "Ndertimi i rruges dalja per Peje-Pjese e qarkores se gytetit" me Autoritetin Kontraktor Komuna e Gjakoves dhe ajo eshte e interesuar te marre me qera mjetet e nevojshme per kryerjen e punimeve , ne rast fitimi te tenderit, sipas listes se me poshtme: Pra eshte fjale per projektin "Ndertimi i rruges dalja per peje-pjese e qarkores se gytetit"-KK Gjakove. Thjesht kjo kontrate per qira eshte e pavlefshme dhe nuk mund te merret parasysht sepse eshte e lidhur per nje projekt tjetër. Kjo kontrate nuk ka vlere per asnje nga pajisjet qe jane te cekuar ne late kontrate sepse nuk ka te beje me ate projekt dhe nuk konsiderohet e vlefshme. Sa per krahasim, ju sqarojme se nje kontrate tjetër e lidhur po nga keto dy pale, dhe e dorezuar me dosje te tenderit shkruan qarte dhe specifikohet se eshte per kete projekt e qe gjendet ne faqe 202 ne pjesen 29 te dosjes se dorezuar dhe shkruan si ne vijim: Duke qene se ; Shoqeria "PE-VLA-KU" sh.p.k. merr pjese ne tenderin "Ndertimi i rruges X" me Autoritetin Kontraktor Komuna e Gjakoves dhe ajo eshte e interesuar te marre me qera mjetet e nevojshme per kryerjen e punimeve , ne rast fitimi te tenderit, sipas listes se me poshtme: Nga keto sqarime, kuptohet qarte se grupi i OE to rekomanduar per kontrate nuk ka ofruar deshmi per pajisjen Kamion sperkates per bitum dhe emulsion. Nga deshmitë qe u ceken me larte kuptohet qarte se grupi i OE te rekomanduar per kontrate ka ofruar kontrata qe nuk jane lidhur per kete projekt dhe qe nuk kane asnje vlere per kete projekt, mirepo ka edhe kontrate qe eshte e lidhur per kete projekt, prandaj nga ky krahasim kuptohen deshmitë dhe kontrata qe nuk jane per kete projekt. pretendimi 6 ankimor lidhet me pretendimin nr: 5 ndaj eshte bashkengjitur kontrata e cila ka te beje me nje projekt tjetër por nuk lidhet me "Ndertimi i rruges dalja per peje-pjese e qarkores se gytetit"-KK Gjakove. Pretendimi juaj ankimor është i bazuar në informacionin e vërtetuar dhe të dokumentuar , pra kontrate e prezentuar nga OE te rekomanduar per kontrate pas kerkeses per informacione shtese eshte derguar kjo marreveshje e cila nuk i ploteson kerkesat e nje kontrate per aktivitetin e prokurimit: "Ndertimi i Rruges X" me nr. të prokurimit: "632-23-397-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS por behet fjale per nje projekt tjetër si "Ndertimi i rruges dalja per peje-pjese e qarkores se gytetit"-KK Gjakove.

Nisur nga të gjitha këto të gjetura dhe konstatime, rrjedhimisht OE ankues Asphalt Group SH.P.K.-Gurebardhi SH.P.K.- Benita Company - Dreoni SH.P.K, është i pa përgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit por pretendimet ankimore ndaj GOE i rekomanduar për kontratë Pe Vla-Ku & Joos Krasniqi -Baze dhe Roza Komani B.I janë të qëndrueshme dhe po ashtu GOE i rekomanduar për kontratë nuk është i përgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit dhe AK lidhur me përzgjedhjen e këtij GOE si fitues nuk ka vepruar në harmoni me nenin 59 dhe 60 të LPP. Andaj si përfundim ankesa e OE ankues është pjesërisht e bazuar ngase ka ofruar fakte dhe pretendimet ankimor ndaj të rekomanduarit i ka të bazuara ashtu siç janë cekur më lartë nga konstatimet e këtij paneli.

Pohimet ankimore të OE ankues "Viktor Com, Pjeter Qerimi B.I - Company Eskavatori SH.P.K.- Marish SH.P.K".

Ankuesi, ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të AK nga aspekti i eliminuar të tij/sajë se rsyetimi i eliminimit lidhur me atë se ne si kompani nuk kemi plotësuar Ankesin e Kontratave eshte i pa bazuar pasi qe ne kemi plotësuar dhe bashkangjitur listen e Projekteve sipas Aneksit te Dosjes se Tenderit eshte cekur Aktiviteti i Prokurimit si dhe Nr i prokurimit. Gjithashtu sipas Aneksit qe eshte ne dosjen e tenderti mund te paraqesim nje dokument tjetër qe evidenton perforormimin e tillë para ne jemi konform kriterëve te kontrates dhe e plotësojm Aneksin e Kontratave siq eshte para pare ne DT gjithashtu do ju bashkangjesim si deshmi edhe njehere

Listen e Projekteve. Vretje qfar do liste qe bashkangjesim ne lidhje me listen e projektve eshte e pranushme sipas LPP dhe UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK pra ju si AK jeni duke tentuar qe te beni diskriminim dhe mashtrim. “Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kriteret që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës -PROVE – Lista e Projekteve Ankesi i Kontratave. Lidhur me këtë ekspert shqyrtues konstaton se duke marrë parasysh dokumentacionin e ofruar OE nuk ka shkelur kriteret e tenderit, përkundër pretendimeve të AK-se që thonë se keni mospërbushje të kriterëve. Sipas informacionit që gjendet në e- prokurimi, ju keni plotësuar kriteret dhe dokumentacionin sipas Aneksit 7 të Dosjes së Tenderit dhe keni paraqitur një listë të projekteve për të dëshmuar përbushjen e këtyre kriterëve gjithnjë duke i plotësuar të gjitha informatat që kerkohen në Aneksin 7 edhe pse ky aneks nuk është plotësuar si dokument konkret. Arsyeimi i OE për të kundërshtuar pretendimet e eliminimit është i bazuar në faktin se ka plotësuar kërkesat dhe detyrimet e kontratës dhe tenderit. Pra lista e projekteve si dëshmi e përbushjes së kriterëve të tenderit është dokument i cili e përmbush këto kriter. Pra OE ankues ka paraqitur një listë të projekteve si dëshmi e punës në të kaluarën, që tregon për përbushjen e kriterëve të tenderit. Gjithashtu, duke iu referuar Aneksit 7 të Dosjes së Tenderit i pa plotësuar por bashkëngjitja e listës së projekteve të cilat i përmban të gjitha përshkrimet ashtu siq është në aneksin 7 , nuk paraqet problem në vertetim për të eliminuar OE ankues. Pretendimi 1 i operatorit ekonomik ankues, bazuar në dokumentacionin e ofruar është **i bazuar** sepse plotësimi i këtij dokumenti nuk e ndryshon rrjedhën e vendimit përfundimtar pasi që informatat në Aneksin 7 janë njësoje me Listen e Kontratave siq është paraqitur në DT. Po ashtu edhe ekspert shqyrtues. Edhe paneli shqyrtues njëjtë sikurse ekspert shqyrtues konstaton se OE ankues ka ofruar listen e kontratave të realizuara e të cilat është me përmbajtje të njëjtë si në DT duke ja bashkëngjitur të gjitha dëshmit konform kërkesës së Dosjes së Tenderit, andaj pretendimi ankimor është i bazuar.

Ankuesi, ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të AK nga aspekti i eliminuar të tij/sajë se arsyeimi, tjetër i eliminimit lidhur me listen e pasijëve si pas Ankesit të DT edhe ky pretendim është i pa bazuar sepse në kemi paraqitur Listen e Pasijëve sipas DT mbas ndryshimeve që i keni bërë ju si AK në kushtet dhe kriteret e DT. Ju si AK jeni në kundërshtim me kërkesat tuaja të DT andaj kërkoj këto pretendime nga ju janë të pa bazuara. “Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kriteret që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës -PROVE – Lista e Pasijëve Pretendimi ankimor 3. Lidhur me arsyetimin tjetër se inç ju mungon certifikatat për siguri dhe shëndet në punë është e pa bazuar pasi që në kemi paraqitur inç Zijadin Mehmeti i cili ka certifikatën Siguria dhe Shëndeti në Pune, do të ju bashkëngjesim dëshmit. Në si GOE i plotësojmë të gjitha kërkesat e parapara në dosjen e tenderit dhe jemi të përgjegjshëm sipas Kriterëve të DT andaj pretendimet nga AK janë të pa bazuara dhe nuk janë konform të DT pra vlersimi nuk është bërë sipas Kriterëve të FDT-se me posht mund të gjeni dëshminë e sipas DT. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 50 (pesdhjetë) punëtorë si dhe staf të mjaftueshëm profesional për kryerjen e projektit si në vijim a).Një inxh. Ndërtimtarisë i inxhinierisë së Ndërtimtarisë (drejtimi konstruktiv apo infrastrukturës rrugore),ose Master i inxhinierisë së Ndërtimtarisë (drejtimi konstruktiv apo infrastrukturës rrugore), mënyrë e projektit me 5 vite përvojë pune pas diplomimit për mënyrë të projekteve. b).Një inxh. i dipl. i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv, ose Master drejtimi konstruktiv udhëheqë i punishtës me 5 vite përvojë pune pas diplomimit si udhëheqës në punishtë në projektet e ndërtimit, rehabilitimit apo ri-konstruktimit të rrugëve, të jetë i certifikuar për mënyrë dhe organizim të kantierit. c).Një inxh. i dipl. i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv ose Master drejtimi konstruktiv me 5 vite përvojë pune pas diplomimit dhe dëshmi se

ka realizuar së paku 2 projekte te natyrës se njejtë. Të jetë i certifikuar për mbrojtje dhe siguri ne pune. Ç).Një inxh. i dipl. i gjeodezisë i licencuar me 3 vite përvojë pune pas diplomimit dhe dëshmi qe ka realizuar minimumin 2 projekte ne lëmin e kërkuar. d).Një inxh. i dipl. i Ndërtimtarisë drejtimi Hidroteknikë me 3 vite provojë pune pas diplomimit. Dh).Një inxh. i dipl. i Elektroteknikës ose Master me 3 vite përvojë pune f).Një inxh. i dipl. i Komunikacionit me 3 vite përvojë pune pas diplomimit ose bachelor i diplomuar i komunikacionit me 5 vite provojë pune pas diplomimit. “Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës PROVE – Lista e Ing dhe deshmive tjera. Sipas Ligjit te Prokurimit Publik dhe UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK konkretisht sipas Nenit 38 Sqarimi i Tenderëve është dashur te kerkohet sqarime shites per te plotesuar ose sqaruar dokumentet e paraqitura pra AK nuk e ka marr per baze Ligjin e Prokurimit Publik dhe ka propozuar nje GOE te pa pergjegjshem me posht gjeni sqarimin si pas Udhzuesit Nr.001/2023 per Prokurim Publik. Neni 38 Sqarimi i Tenderëve 38.1 Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkojë nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një formular standard B47 për sqarime për të përdorur nga AK “Kërkesë për sqarim të tenderit”. Kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të bëhet përmes platformës elektronike. 38.2 Asnjë ndryshim në çmim ose kusht tjetër material ose aspekt të tenderit nuk mund të kërkojë, ofrohet ose lejohet. 38.3 Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkojë dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë. 38.4 Autoriteti kontraktues do të sigurojë mundësinë e sigurimit të informacionit shites në kushte të njëjta për të gjithë Operatorët ekonomik dhe do të kërkojë informacion nga Operatorët ekonomik me qëllim të qartësimit të përmbajtjes së deklaratave të paqarta, çertifikatave të përfshira në tenderë apo kërkesave për pjesëmarrje. Sqarimi dhe kërkesa për informacion shites, informacion plotësues dhe dokumente është pjesë e procedurës së vlerësimit. Kërkesa kalon / nuk kalon dhe vlefshmëria e ofertave/aplikacioneve mund të vendoset vetëm pas dorëzimit të përgjigjeve në pyetjet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe pas shqyrtimit të dokumenteve shites të paraqitura. 38.5 Autoriteti kontraktues mund të ftojë Operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë çertifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-se d.m.th dëshmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, çertifikatat e kualitetit, kërkesat e grupeve të OE. Lidhur me këto pretendime ankimor paneli shqyrtues mendon se nuk ka nevojë të lëshohet fare për shkak se sipas vendimit mbi kërkesën për ri-shqyrtim të AK-se të datës 03.08.2023 pjesa tjetër nga OE ankues është e plotësuar dhe si e tillë konsiderohet se ju jeni në rregull përderisë sa AK nuk ka dhënë përgjigje në pretendimet tjera por vetëm në pretendimin nr 1. Megjithatë, OE ankues ka ofruar prova të mjaftueshme mbi përgjegjshmërinë e tyre dhe plotësimit të këtyre kërkesave dhe AK lidhur me këtë mund të shfrytëzojë nenin 72 të LPP. Paneli shqyrtues ashtu sikurse eksperti shqyrtues konstaton se pretendimin e klasifikon si të bazuar. Paneli detyrohet të marrë në konsideratë faktin parimore se, tenderi I ofruar nga OE ankues është për 199,996.88 €, më i lirë se OE i rekomanduar për kontratë, e që ky fakt nuk mund të mohohet as nga AK. Përveç kësaj AK duhet të ketë parasysh edhe dispozitat e neneve 1, 6 dhe 7, përmbajtja e të cilave përbën fakt notor për të gjitha AK dhe OE.

Ankuesi, ka atakuar po ashtu edhe vendimin e AK nga aspekti i përgjegjshmërisë së OE të rekomanduar për kontratë por paneli shqyrtues nuk e sheh të nevojshme të lëshohet në ato konstatime kur disa prej tyre janë veç se janë trajtuar në ankesën me nr. 2023/0560 dhe

rrjedhimisht ka rezultuar se GOE është i pa përgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7, 59, 60 dhe 72 të LPP. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Po ashtu, vlerësimi i panelit shqyrtues nisat edhe nga fakti se secili OE ofertues mban përgjegjësi që oferta e tij/saj të jetë konform kërkesave të përcaktuara në Dosje të Tenderit dhe për çdo paqartësi për ndonjë krëkesë të vendosur në dosje të tenderit kanë të drejtë ta atakojnë në fazën e para ofertimit, qoftë edhe me ankesë në OSHP, në të kundërtën ata si të tillë ato bëhen obligative për secilin ofertues. Kurse, AK është i obliguar që vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve ta bëjë konform nenit 59 të LPP. Si dhe konform nenit 56.3 të LPP, në të cilin përcaktohet se: "Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit". Si dhe në kuptim të nenit 7 që secili OE pjesëmarrës të trajtohet drejtë dhe barabartë.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS, KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - "ASFALT GROUP" SH.P.K., N.SH.T. VIKTORY COM**
- Arkivës së OSHP-së: